

16



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

25-10-2017



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretarati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 63 paragrafi 4 dhe 54 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 4 paragrafi 2 të Rregullës Zgjedhore nr. 10/2013, Raundi i Dytë i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datën 26.10.2017, merr këtë :

V E N D I M

Për Anulimin e distinktivëve të vëzhguesve të subjekteve politike dhe organizatave joqeveritare vendore të zgjedhjeve lokale të 22 tetorit 2017

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për anulimin e distinktivëve të vëzhguesve të subjekteve politike dhe organizatave joqeveritare vendore të zgjedhjeve lokale të 22 tetorit 2017.
- II. Distinktivët e Raundit të parë të zgjedhjeve lokale të 22 tetor 2017, vlejnë deri me datë 18 nëntor 2017.
- III. Obligohet Zyra për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Me këtë vendim Komisioni Qendror i Zgjedhjeve eliminon mundësin e keqpërdorimit të distinktivëve të vëzhguesve të subjekteve politike dhe organizatave joqeveritare vendore të cilët janë pajisur me distinktivë në zgjedhjet lokale të 22 tetorit 2017.

Subjektet Politike dhe OJQ-të vendore për tu pajisur me distinktivë për Raundin e dytë të Zgjedhjeve për kryetar të komunave që do të mbahen më 19.11.2017 duhet të konfirmojnë listat e vëzhguesve deri me datë 13.11.2017. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka